



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



Nr. 277 .Prot
Nr.1285.Regj

Tiranë, më datë 16.01.2020

VENDIM

Për shpalljen në ankand të dytë të pasurisë së paluajtshme

Pranë Zyrës Përmbaremore Private “Bailiff Services Albania” sh.p.k, është depozituar kërkesa e palës kreditore “Credins Bank” sh.a. në date 09.12.2013 sëbashku me **Urdhërin e Ekzekutimit nr. 12-2012-2185 datë 12.09.2012** të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë të lëshuar për **Kontraten e Kredisë Afatgjate nr.28/date 18.09.2008, nr.2032 rep, nr.921 kol date 22.09.2008 me pale:**

- Kreditor: “Credins Bank” sh.a.
- Debitor: Skender Gjumsi
- Dorëzues: P.F “Skender Gjumsi”, Kimete-Gjumsi
- Objekti: Kthim kredie

Në bazë të nenit 517 të K.Pr.Civile i është komunikuar palës debitor njoftimi për kryerjen e ekzekutimit në mënyrë vullnetare. Me marrjen dijeni nga ana e palës debitor nuk është vepruar për shlyerjen e detyrimit. Për rrjedhojë në bazë të nenit 519 të K.Pr.Civile për të bërë të mundur ekzekutimin e titullit, ekzekutimi është kaluar në ekzekutim të detyrueshëm duke vendosur masën e sekuestros mbi pasurinë e paluajtshme të palës debitor. Pasi është vendosur masa e sekuestros nga ana jonë i është dërguar njoftim palëve debitor dhe kreditor që brenda afatit ligjor prej 7 (shtatë) ditësh të caktojnë me mirëkuptim ndërmjet tyre çmimin e pasurisë së paluajtshme. Megjithatë afati ka kaluar pranë zyrës përmbaremore nuk është depozituar asnjë marrëveshje për caktimin e çmimit të pasurisë së paluajtshme. Për rrjedhojë për vlerësimin e pasurisë së sekuestruar në përputhje me nenin 564 të K.Pr.Civile është caktuar ekspert i licencuar i cili ka kryer vlerësimin e pasurisë së paluajtshme të palës debitor. Në bazë të aktit të ekspertimit të paraqitur nga eksperti si dhe mbështetur në nenin 564 të K.Pr.Civile është caktuar çmimi i pasurisë së paluajtshme. Ky çmim i’u është komunikuar palëve në proces ekzekutimi sëbashku me aktin e vlerësimit të pronës. Gjithashtu i është lënë afat palës debitor për të shlyer detyrimin por nga ana e saj nuk është vepruar, si dhe pranë zyrës përmbaremore nuk është depozituar asnjë vendim gjyqësor për pezullimin e veprimtarisë përmbaremore. Me Proces verbalin e datës 26.11.2019 është zhvilluar ankandi i parë për pasurinë e paluajtshme Nr.4/164-ND, vol 4, faqe 22, ZK 3234, lloji i pasurisë (ndertese) me sip 70 m², me adrese Rrogozhine, në pronësi të Skender Haziz Gjumsi, me vlerë 5,600,000 leke, i cili është mbyllur duke mos u arritur të shitet sendi. Në këto kushte në bazë të nenit 557 të K.Pr.Civile duhet të zhvillohet ankandi i dytë për shitjen e pasurisë së paluajtshme me një çmim të ri jo më të ulët se 30 përqind të çmimit të përcaktuar në ankandin e parë.